



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 66 datë 01.07 2026

PËR PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 125, DATË 17.12.2025 TË KËSHILLIT BASHKIAK PËRMET “PËR MIRATIMIN E NMARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET BASHKISË PËRMET DHE FSHF-SË, MIRATIMIN E FINANCIMIT TË FSHF-SË PËR RIKONSTRUKSIONIN E PJESSHËM TË STADIUMIT DURIM QYPI, “PËRMET”, SI DHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË KRYETARIT TË BASHKISË PËR NËNSHKRIMIN E SAJ”.

Këshilli Bashkiak Përmet, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të ndryshuar, E-mail të dërguar nga FSHF datë 29.5.2026 “Për ndryshime në draft marrëveshje” si dhe në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF), me qëllim garantimin e realizimit në kohë të projektit dhe përmbushjen e detyrimeve financiare të marra përsipër nga Bashkia Përmet,

VENDOSI:

1. Kontributi financiar i Bashkisë Përmet për vitin 2026, në vlerën 9,913,000 (nëntë milionë e nëntëqind e trembëdhjetë mijë) lekë, do të disbursohet në favor të Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) menjëherë pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të kontratës.
2. Të gjitha dispozitat e tjera të Vendimit nr. 125, datë 17.12.2025, të Këshillit Bashkiak Përmet, të cilat nuk preken nga ky ndryshim, mbeten në fuqi.
3. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë Përmet, Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit Të Territorit, Sektorit Juridik Dhe Prokurimeve, Drejtorisë Së Financës, Burimeve Njerëzore Dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria E Zhvillimit Ekonomik Bujqesi Turizëm.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

Në mungesë dhe me porosi
Nënkryetari i Këshillit të Bashkisë Përmet
Agim ANDONI

